



A.nr.789/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Malsore Gashi Bajraktari anëtare, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.789/2026 të datës 14.07.2026, të parashtruar nga ankuesit V.A, S.Q, F.S, (grup ankuesish) të cilët me autorizim i përfaqësojnë Shoqëria e avokateve “Klinaku Associates nga Prishtina, kundër organit të punësimit/ Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, në Prishtinë, në çështjen juridike “*Kompensim Material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.08.2026, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesën A.nr.789/2026 të datës 14.07.2026, të parashtruar nga V.A, S.Q, F.S (grup ankuesish) të cilët me autorizim i përfaqëson Shoqëria e avokateve “Klinaku & Associates nga Prishtina.

A r s y e t i m

V.A. S.Q. F.S. (grup ankuesish) të cilët me autorizim i përfaqëson Shoqëria e avokateve “Klinaku & Associates nga Prishtina, me datë 14.07.2026 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 3103/2026, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos kompensimin e për vlerën sipas përvojës së punës nga 0.25% e tutje në 0.50% nga koha e hyrjes në fuqi të Ligjit të Pagave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshme referuar: *Kolegji i Këshillit*) nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.789/2026, të datës 14.07.2026 të parashtruar nga ankuesit e larte shënuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se të gjithë ankuesit janë të punësuar në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, sipas aktit të emërimit të datës 05.02.2024 ankuesja F.S. mbanë pozitën e punës “*Asistente në Zyrën e Rektorit*”, ankuesja V.A. sipas akt emërimit me numër 499 të datës 01.03.2012 mbanë pozitën e punës “*Punëtore e Bufes*”, ankuesi S.Q., sipas ndryshim dhe plotësimit të aktit të emërimit me numër 1/18 të datës 02.05.2013 mbanë pozitën e punës “*Zyrtar i Prokurimit*”.

Ankuesit e lartpërmendur me datë 14.07.2026 përmes përfaqësuesit me autorizim kanë parashtruar kërkesë tek organi i punësimit lidhur me kompensimin material në emër të shtesës në pagë për përvojën e punës nga 0.25% deri në 50% ndërsa kjo e fundit nuk i është përgjigjur.

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës së Këshillit për shqyrtim dhe vendosje lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit iu referua Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 5 më të cilin përcaktohet se:

*Kategoritë e zyrtarës/it publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit. 2. Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunës/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunës/ës i shërbimit civil, me ligji të veçantë. 3. Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i **cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues.** Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës....”, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rezulton së të gjithë të punësuar duke përfshirë zyrtarët e nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të institucioneve publike arsimore të Kosovës kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publikë, kështu, nisur nga fakti se të gjithë ankuesit sipas akt emërimeve janë të punësuar në Universitetin e Prishtinës, Kolegji konstaton së ankuesit si më lartë nuk kanë statusin e nëpunësit civil, andaj, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, rrjedhë së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.789/2026 të datës 14.07.2026 të parashtruar nga ankuesit.*

Pas konstatimit si më lartë, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.789/2026, andaj bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA A.Nr.789/2026.**

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Avokaturës Klinaku & Associates;
- Udhëheqësit të Personelit në Universitetin e Prishtinës ‘‘Hasan Prishtina’’, në Prishtinë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.